



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 40.2 shkronja d) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenit 13 paragrafi 1.2 të Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, neneve 14, 15 paragrafi 2.3 dhe 34 paragrafi 2.4 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, në propozim të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 janar 2026, mori këtë,

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT AD-HOC PËR HARTIMIN E DRAFT PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2026

Neni 1

Me këtë vendim formohet komisioni ad-hoc për hartimin e Draft Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2026, në këtë përbërje;

1. **Isak Shabani**, kryesues i komisionit
2. **Vlora Humolli - Jashanica**, anëtare nga radhët e Kuvendit
3. **Arnisa Sylejmani**, anëtare nga radhët e Kuvendit
4. **Rinesa Goxhufi**, anëtare nga radhët e Kuvendit
5. **Demokrat Hodolli**, anëtar nga radhët e Kuvendit
6. **Gentrit Arifi**, anëtar nga radhët e Kuvendit
7. **Baki Feta**, anëtar nga radhët e Kuvendit
8. **Bahri Selimi**, anëtar nga radhët e Ekzekutivit
9. **Lirie Hoti - Rama**, anëtare nga radhët e Ekzekutivit
10. **Avni Fetahu**, anëtar nga radhët e Ekzekutivit
11. **Saranda Stublla - Uka**, anëtare nga radhët e Ekzekutivit

Neni 2

Komisioni sipas këtij vendimi, përgatit draftin fillestar të Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026, organizon konsultime publike si dhe zhvillon të gjitha veprimet e nevojshme procedurale deri në hartimin final dhe procedimin në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Neni 3

Komisioni bashkëpunon dhe koordinon me Ekzekutivin e Komunës dhe shërbimet përkatëse në kuadër të Institucionit të Komunës së Podujevës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryesuesi i Kuvendit,

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform dispozitave të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, Ligjit nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si dhe Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren (QRK) nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-020/04-0006424/26
Podujevë, datë; 29 janar 2026



Kryesuesi i Kuvendit
Isak Shabani